

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.14/2024	Data: 31.01.2024	

Kuvendi i Komunës në baze të nenit 40 paragrafi 40.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenit 33 paragrafi 33.1 pika 4 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, në mbledhjen e mbajtur me 31.01.2024 Shqyrtoj Raportin e Planit të Integritetit për vitin 2023, dhe nxjerri këtë:

NJOFTIMIN ME RAPORTIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR VITIN 2023

1. Kuvendi i Komunës shqyrtojë dhe debatoj Raportin e Planit të Integritetit për vitin 2023.
2. Raporti është pjesë përbërës e këtij njoftimi.
3. Me kopje të këtij Njoftimi të njoftohen: Zyra përgjegjëse e ketij raporti dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendi.

	REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E ISTOGUT - OPŠTINA ISTOK DEKRETI PËR ADMINISTRATË - DIREKCIJA UPRAVE	
II		
Nr./Br. <u>00-033-12</u> Nr. i faq/Br.str. <u>01</u>		
Data/Datum <u>01 / 02 / 2024</u> ISTOG • ISTOK		

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova






Republika e Kosovës
Republika kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opstina Istok
Istog Municipality

KRYETARI I KOMUNËS

DATE/DANA:	15.01.2024
PËR/ZA/TO:	z.Enver Rugova, Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	znj.Delvina Sylaj, Koordinatore për Planin e Integritetit
NGA/OD/FROM:	z.Genc Ademaj, Drejtör i Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për Procedim për pikë të rendit të ditës në Kuvendin e Komunës

I nderuar,

Me anë të kësaj shkrese kërkoj nga ju si Kryesuesi i Kuvendit Komunal, që në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës, të parasheh si pikë të rendit të ditës për shqyrtim/diskutim:

1.Diskutimin e Raportit të Planit të Integritetit për Komunën e Istogut.

Bashkangjitur gjeni edhe materialin për pikën e cekur për rendin e ditës.

Me respekt!



KOMUNA E ISTOGUT
OPSTINA ISTOG
MUNICIPALITY OF ISTOG

RAPORT
ZBATIMI I PLANIT TE INTEGRITETIT
KOMUNA E ISTOGUT

Istog, 2023

PËRMIRËSITË:

HYRJA.....	3
QELLIMI DHE STRUKTURA E RAPORTIT.....	4
METODOLOGJIA.....	5
MONITORIMI.....	6
PËRSIKRIM I RAPORTIT TE MONITORIMIT TE PLANIT TE INTEGRITETIT.....	7
KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET.....	17

Bazuar në Ligjin nr 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, përkatësisht, neni 25 i këtij Ligji ka obliguar autoritetet komunale të Kosovës që të bëjnë miratimin e Planit të Integritetit (6) muaj pas miratimit të Metodologjisë së Planeve të Integritetit nga Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe strategjinë e shtetit kundër korrupsionit, me të cilat të gjitha institucionet kanë qenë të obliguara që të zbatojnë Planin e Integritetit. Komuna e Istogut ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2023-2026. Ky Plan përmban në vete suazat e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit dhe format e tjera me të cilat cenohet integriteti, pa mënjnau specifikimin e masave parandaluese dhe fuqizimin e sundimit të ligjit. Plani për Integritet i Komunës së Istogut konsiston në seriozitetin dhe përkushtimin për të arritur objektivat e komunës dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

Plani i Integritetit ofron këto mundësi:

Identifikimin e rreziqeve të korrupsionit, që paraqiten brenda fushave të ndryshme të punës, në Komune.

Vendosjen, vlerësimin dhe verifikimin e integritetit të organizatës, dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së një organizate dhe ekspozimin e saj ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit.

Përcaktimin e masave që reduktojnë ose eliminojnë rreziqet e korrupsionit brenda organizatës (përfshirë këtu edhe sjelljet jo profesionale).

Plani i Integritetit pritet të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:

Krijimin e mundësive që Komuna të arrijë objektivat e saja organizative duke vënë përpara një menaxhim pro-aktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësojë rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe do të zvogëlojë/eliminojë mundësitë për korrupsion.

Përqendrimin tek prioritetet, në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do ta ndihmojnë komunën të shpërndajë në mënyrë efektive burimet e disponueshme kundër korrupsionit në mënyrë që të shfrytëzohen në mënyrën më mirë të mundshme;

Përmirësimin e kontrolleve operacionale ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve;

Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet përkatëse ligjore dhe procedurale;

Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm kundër korupsion përmes trajnimit të synuar dhe ndërgjegjësimit, si dhe duke inkurajuar një bashkëpunësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;

Rritjen e mëtejshme të besimit të palëve të brendshme dhe të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga Komuna.

Zbatimi i këtij Plani, do të bëjë komunën që të jetë në pozitë më të mirë për të siguruar përkushtim, efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë grumbullimit të rezultateve të synuara, përfshirë këtu përmirësimin e shërbimeve për publikun dhe grupeve të interesit. Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi të vlerësimit të rrezikut të bërë nga komuna, në qëllimet e forcimit të transparencës, publikimit pro aktiv të info-ve në faqet e internetit, eliminimin e ndikimit të jashtëm në punën e punonjësve, , në rastet e shkeljes së integritetit dhe vlerësimin e tyre duhet marrë parasysh dëmet materiale dhe jo materiale, që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale, ku si rrjedhojë e kësaj paraprakisht bëhet përzgjedhja e masave adekuate për të arritur qëllimet dhe përmirësimet në ngecjet ose moszbatimet e fushave të caktuara.

QËLLIMI DHE STRUKTURA E RAPORTIT

Ky Raport ka për qëllim sqarimin e zbatueshmërisë dhe moszbatueshmërisë në pika dhe fusha të caktuara nga zyrtarë dhe udhëheqës të Komunës së Istogut për vitin 2023. Ky raport ofron kornizën konceptuale mbi matjen e faktorëve të rrezikut që përbëjnë Planin e Integritetit. Në pika të shkurta, janë paraqitur disa faktorë kryesorë të rrezikut të këtij plani, e të ndarë sipas fushave.

Fushat e përgjithshme të rrezikut:

Drejtimi dhe menaxhimi

Specifikat e Burimeve Njerëzore, sjelljet etike, profesionale të punëtoreve

Komunikimi- Informimi me kohe,

Ruajtja e te dhënave

Planifikimi buxhetor

Fushat specifike:

Administrata Komunale

Prokurimi publik

Subvencionet, grantet

Inspektimet

Rekrutimet e stafit

Planifikimi Urban dhe Rural

METODOLOGJIA

Ky raport fokusohet ne elementet e rrezikut te paraqitur ne Planin e Integritetit, andaj si pikënisje e kemi pasur pyetësorët te cilët janë plotësuar nga Drejtorë/sh , Udhëheqës dhe Zyrtarë kompetent qe ndërlidhen me zbatimin e Planit te Integritetit. Pas shqyrtimit dhe analizimit te përgjigjeve, ne kemi krijuar tabelën qe vijon me poshtë, duke përfshirë shkallen ose nivelin e zbatimit për secilën fushe ose faktor te rrezikut.

MONITORIMI

Zbatimi i Plani të Integritetit nënshtrohet një procesi periodik monitorimi dhe vlerësimi. Ky proces do të kryhet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve, punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës, që do të caktohen në të gjitha strukturat përgjegjëse.

Në kuadër të monitorimit, koordinatorët do të përgatitin dhe përcjellin raportimet vjetore, të cilat do shërbejnë për të vlerësuar shkallën e realizimit të masave, aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuar në Plan, si dhe efektivitetin e masave.

Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga kryetari i Komunës, i cili është përgjegjës për raportim. Raportimi lejon Kryetarin të ndërmarrë me kohë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

PËRSHKRIMI I RAPORTIT TE MONITORIMIT TE PLANIT TË INTEGRITETIT

Me përfundimin e punës së monitorimit për Plan të Integritetit bëjmë këtë:

Konstatim:

Në Planin e Integritetit janë përfshirë 46 faktorë të rrezikut. Pas kryerjes së monitorimit dhe pranimit të përgjegjëseve të plotësuar nga drejtoritë përkatëse, kanë gjetur se ka pasur progres në zbatimin e aktivitetëve në Planin e Integritetit për vitin 2023. Kështu, bazuar në të dhënat e nxjerra, në tabelën më poshtë ju paraqesim realizimin e Planit të Integritetit për vitin 2023:

Nr	Përshkrimi i Rrezikut	Përshkrimi i Masës	Njësia Përgjegjëse	E Plotësuar	Pjesërisht E Plotësuar	Ende Ska Filluar
1	Mungesa e programit të duhur të trajnimit për stafin.	Komuna ka të hartuar për çdo fillim të vitit plan programin për trajnimin e stafit.	Spektori për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	x		
2	Nuk ka aktivitete të ndërgjegjësimit apo trajnime për papajtueshmërinë e funksionit.	Aktivitetet e ndërgjegjësimit janë të mbuluara me takime pune që mbahen me DEMOS, USAID dhe NDI.	Spektori për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	x		
3	Mungesa e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal	Azhurnimi me kohë i dokumenteve pa u përmbyllur afati i skadimit, hartimi dhe aprovimi	DEZH			x
4	Vonesat dhe pengesat objektive për funksionalizimin e zonës ekonomike	Kryerja e punimeve dhe pranimi teknik i zonës ekonomike. Hartimi i planit për vendosjen e bizneseve	DEZH	x		
5	Mos mbështetja e start-up bizneseve përmes garantë-ve të vogla	Mungesa e planifikimit buxhetor për këtë fushë	Kuvendi dhe DEZH			x

6	Përqendrimi i investimeve të huaja në vendet tjera	Klima jo e favorshme për joshjen e investimeve të huaja direkte, si mungesa e strategjive lokale për fuqizimin e kapitalit njerëzor me nevojat e tregut të punës. Mungesa e një baze të të dhënave për investitorët e huaj.				
7	Numër i ulët i turistëve dhe vlerave turistike, krijimi i të ardhurave nga ky sektor janë minimale.	Mungesa e paketave turistike profesionale dhe e promovimit profesional të produktit turistik. Mungesa e sektorit të turizmit.	DEZH			x
8	Mungesa e sektorit ligjor në kuadër të drejtorisë	Shqyrtimi i ankesave, përfaqësim ligjor , hartimi i sakte me shkresave	Drejtoria e Inspeksionit			x
9	Mungesa e fushatës sensibilizuese	Përmes këtyre fushatave arrihet që qytetaret të njoftohen me rendësin dhe pasojat e mos respektimi të ligjeve Inspektuese	Drejtoria e Inspeksionit, Njësi për Burime Njerëzore			x
10	Mungesa e trajnimeve profesionale-vizitave studimore	Marrja e njohurive dhe eksperiencave rreth implementimit të detyrave adekuat dhe aktuale. Si dhe pjesëmarrja në vizita të ndryshme studimore	Drejtoria e Inspeksionit		x	

11	Hartimi i Planit të Punës	Si një plan menaxhues i detyrave tona si Drejtori	Drejtorja e Inspeksionit			
12	Hartimi i akteve nënligjore.	Përmes këtyre akteve të zbatohet vullneti (rregulloreve) i inspektoreve në zbatim të së drejtës	Drejtorja e Inspeksionit		x	
13	Luftimi i Ekonomisë jo-formale	Regjistrimi i bizneseve Verifikimi i kushteve minimale teknike dhe paisja e subjekteve me pëlqim për të ushtruar veprimtari biznesore; Kontrollimi në automjete transportuese që bartin mallrave për tregti, etj.	Drejtorja e Inspeksionit, Sektori i Tregut			x
14	Mungesa e një ekipe për inkasim të detyruar të TP.	Formimi i një ekipe për menaxhimin permanent të borxheve të mëdha, reflekton pozitivisht në uljen e tyre dhe shtimin e inkasimit të TP.	Drejtorja për Buxhet dhe Financa			x
15	Ankesat e shumta të tatimpagueseve gjatë vitit, për mos pranimin e faturës së tatimit në prone. Shpërndarjen e bën Posta e Kosovës Njësia në Istog, sipas Kontratës me Komunën	Një shpërndarje me efikasitet, e sakte dhe e afatshme e faturave, është kryesore për ZTP dhe tatimpaguesit.	Drejtorja për Buxhet dhe Financa		x	

16	Mos transparencë për investimet apo participimet e projekteve nga të hyrat e TP për tatimpagues dhe qytetare.	Informimi i saktë për qytetare për investimet në infrastrukturë, nga të hyrat e TP për mirëmbajtjen e tyre, është i nevojshëm dhe motivues.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa.			
17	Mbikëqyrja e realizimit të plan programeve mësimore të mësimdhënësve në tri nivelet arsimore	Sigurimi i kuadrit adekuat profesional dhe sigurimi i trajnimeve profesionale	Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi	X Secila shkollë ka koordinator për vlerësim të cilësisë		
18	Planifikimi i shërbimeve arsimore jo adekuat dhe i paefektshëm	Të sigurohet planifikim i shërbimeve arsimore bazuar në nevojat dhe dinamikën e rritjes së numrit të nxënësve.	Drejtoria për Arsim, MASHT	X		
19	Kontrolli më i rrept i -inspektimi i lokale afër objekteve shkollore	Mos inspektimi i lokale do të ndikon në mundësimin e nxënësve në blerjen e artikujve që janë të dëmshëm për përdorim, si pijet energjetike, cigaret dhe dukurit tjera negative	Kryetari i Komunës, DK A-ja dhe SHPK	X- bëhet inspektimi i kohëpaskohshëm nga inspektorët komunal dhe Shërbimi policor-		

20	Zhvillimi i sistemit te menedhimit te burimeve njerëzore. Mungesa e transparences,meri tokracia,politika,sl afi jo profesional	DKA-ja te jete me transparente, te ketë meritokraci,te punëson staf adekuat etj	Drejtoria për Arsim		X	
21	Kualifikimi i punjtueshëm /niveli i trajnimit të stafit të DKA-së dhe stafit të arsimit për zbatimin e kurikules,planprog rameve dhe shërbimeve tjera arsimore	Sigurohuni që stafi ka kualifikim të mjaftueshëm për zbatimin e shërbimeve arsimore,kurikules,pl anprogrameve etj. Sigurimi i trajnimit adekuat të stafit	Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Arsim, Shkollat.	X		
22	Mungesa e paraleleve për nxënësit me nevoja të veçanta ,ose qendër me qëndrim ditor ku do te ketë staf profesional si logoped,psikolog, pedagog,fiziater etj	Sigurimi i paraleleve apo i qendrës me qëndrim ditor si dhe sigurimi i personelit adekuat për fëmijët me nevoja të veçanta.	MASHT,DKA -ja	X		

	Mungesa e planeve në DKA për sigurimin trajnimeve dhe avancim profesional të punëtorëve arsimor Mungesa e komunikimit të mirëfilltë në mes Drejtorëve të shkollave - DKA-as dhe MASHT	Sigurimi i programeve dhe afateve për trajnime sipas profileve dhe niveleve të arsimit. Bashkëpunimi i domosdoshëm DKA-me drejtore shkollash	Dka-ja dhe Drejtoret e institucioneve arsimore			
24	Përformacë e dobët e personelit mësues, mungesë e mbikëqyrjes së procesit mësues, dhe mos vlerësim i personelit lidhur me performancën e tyre	Organizimi i inspektimeve të përbashkëta me inspektorët e MASHT-it, mbikëqyrja nga drejtoret e shkollave përmes hospitimeve në orë, dhënia e rekomandimeve personelit arsimor për përmirësimin e procesit mësues	Masht, Kryetari i Komunës dhe DKA-ja		X	
25	Kurrikula nuk është praktike	Të ndërmerret një vlerësim i plotë i kurrikulave, të thjeshtëzimi i kurrikulave në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit;	Masht-i dhe Dka-ja		X	
26	Programet lidhur me integritetin dhe etikën nuk promovohen në kuadër të sistemit të shkollave publike	Të promovohen programet lidhur me integritetin dhe etikën në të gjithë sistemit e shkollave publike	Masht-i dhe Dka-ja		X	

27	POSHTA KRYESORE FUNKSIONIMI TE KOMUNES- PROMOVIMI DHE MBROJTJA E TE DREJTAVE TE NJERIUT DHE KOMUNITETE	Te sigurohet qe stafi ka kualifikim te mjaftueshem per zbatimin e promovimit dhe mbrojtjen e sherbimeve te te drejtave te njeriut; Sigurimi i trajnitimit adekuat te stafit	Drejtoria e administrates Sektori per liri, drejta te njeriut dhe komunitete	X		
28	ADMINISTRATA E PERGJITHSHME EKOMUNES- KONTRATAT E BLERJES/PROKU RIMIT	Te siguroje qe stafi ka kualifikim te mjaftueshem per zbatimin e procedurave qe lidhen me kontratat e bleljes / prokurimit; Te siguroj trajnim adekuat per stafin	Zyra e Kryetarit Drejtoria e administrates Sektori i Prokurimit	X		
29	ADMINISTRATA E PERGJITHSHME EKOMUNES- KONTRATAT E BLERJES/PROKU RIMIT	Te siguroje numrin adekuat te stafit per zbatimin e procesit lidhur me kontratat e blerjes / prokmimit	Zyra e Kryetarit Drejtoria e administrates Sektori i Prokurimit	X		
30	ADMINISTRATA E PERGJITHSHME EKOMUNES- KONTRATAT E BLERJES/PROKU RIMIT	Kritja e kontrollit mbi zbatimin e kontratave te blerjeve /prokmimit	Zyra e Kryetarit Drejtoria e administrates Sektori i Prokurimit	X		

31	ADMINISTRATA E PERGJITHSHME EKOMUNES- Administrimi i STOQVE DHE INVENTAREVE	Te mjej kontrolli mbi administrimin e stokeve dhe inventareve	Drejtoria e administrates	X		
32	ADMINISTRATA E PERGJITHSHME EKOMUNES- KONTRATAT E BLERJES/PROKURIMIT	Te sigurohet qe stafi ka kualifikim te mjaftueshem per administrimin e stokeve dhe inventareve; Sigurimi i trajnimit adekuat te stafit			X	
33	ADMINISTRATA E PERGJITHSHME E KOMUNES- PERDORIMI AUTOMJETEVE PUBLIKE	Rritja e sanksioneve per perdorim te paautorizuar te automjeteve publike	Drejtoria e administrates		X	
34	Perdorimi i pa autorizuar i vulave per dokumentet zyrtare.	Vulat te perdoren nga drejtorët dhe shefat e sektoreve me autorizim.	Drejtoria e administrates	X		
35	ADMINISTRATA E PERGJITHSHME E KOMUNES	Rritja e sigurisë se objektit ne hyrje gjate orarit te punës/sigurimi i stafit për siguri	Drejtoria e administrates			X
36	Fatkeqësitë natyrore (erërat, vërshimet nga uji)dhe fatkeqësitë tjera.	Rritja e numrit te mjeteve adekuate ne raste te fatkeqësive	Drejtoria e Emergjencav Mbrojtje dhe Shpëtim		x	

Nr	Zgjedhja	Rrëfimi i punës së zgjatësive interventive(mungesa e stafit intervenues)	Drejtoria			
38	Kritere jo te qarta dhe transparencë e pa mjaftueshme ne ndarjen e subvencioneve për zhvillimin e bujqësisë dhe sektorëve tjerë	Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere dhe procedura te qarta për ndarjen e subvencioneve dhe për të parandaluar vendime arbitrare dhe praktika korruptive	Drejtoria e Bujqësisë pylltarisë dhe Hidroekonomisë		x	
39	Mungesa apo mos rishikimi dhe përditësimi i dokumenteve strategjike për zhvillimin e bujqësisë	Përgaditja e Plan programit 10 vjeçar për bujqësi dhe zhvillim rural dhe Hartës zonale bujqësore	Drejtoria e Bujqësisë pylltarisë dhe Hidroekonomisë		x	

40	Mungesa e vetëdijes për rreziqet në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë	Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve në lidhje me menaxhimin e rreziqeve specifike në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë dhe rreth burimeve alternative	Drejtoria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Hidroekonomisë		x	
41	Kontrolli jo efikas mbi zbatimin e shërbimeve të zhvillimit të përdorimit të tokave bujqësore	Rritja e kontrollit mbi zbatimin e përdorimit të tokës. Fushatë vetëdisuese për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe promovimi i rëndësisë së tokave bujqësore	Drejtoria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Hidroekonomisë		x	
42	Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve kapitale bujqësore	Të sigurohet personel adekuat profesional për përgatitjen e projekteve dhe mbikëqyrje Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e vlerësimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të projekteve	Drejtoria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Hidroekonomisë			x

43	Kurkesa të reja për plotësim ndryshim të PZH, HZK, Plan të hollësishme dhe rregulloret e brendshme që lidhet me fushën e planifikimit urban dhe rural	Hartimi i planeve zhvillimore dhe të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kriteret të qarta të duhura që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe parandalojnë vendimet subjektive	Kryetari i Komunës, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis			
44	Zbatim jo i plotë i ligjshmërisë së brendshme që lidhen me fushën e planifikimit urban dhe rural	Të rritet mbikëqyrja e zbatimit të planeve dhe rregullativës së brendshme	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis		x	
45	Kualifikimi dhe ekspert të pamjaftueshëm të personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për planifikim urban dhe rural	Të sigurohet personel adekuat profesional për planifikim urban dhe rural dhe profesionistët e fushave të caktuara: Inxhinier i mjedisit, ndërtimtarisë, elektros, makinerisë Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural	Planifikim Urban dhe Mjedis		x	

46	Mbikëqyrja jo efikase mbikëqyrja e zbatimit të aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural (kompania mbikëqyrëse)	Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural	Kryetari i Komunës, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis			

Duke u bazuar në të dhënat e tabelës së paraqitur me lartë, konstatojmë që Plan i Integritetit është realizuar si në vijim:

Faktorët e rrezikut të zbatueshëm	Faktorët e rrezikut pjesërisht të zbatueshëm	Faktorët e rrezikut të pazbatueshëm
34.78%	43.47%	21.74%

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Plan i Integritetit është një dokument strategjik si dhe funksional që ka rezultuar nga procesi i vlerësimit të rrezikut, të ndërmarrë në kuadër të Komunës së Istogut, Plan i rritjes angazhimin e komunës për të bërë përmirësimet dhe kontrollet në të gjitha aktivitetet, funksionet dhe veprimtaritë e stafit të Komunës, me fokus në ofrimin e shërbimeve transparente dhe efikase brenda institucionit dhe me palë, me theks të veçantë forcimin e sundimit të ligjit dhe vlerave dhe standardeve profesionale.

Andaj lufta ndaj korrupsionit, konfliktit të interesit dhe çfarëdo forme tjetër të paligjshme ose sjelljeve jo etike duhet të jetë e pakompromis, e vazhdueshme dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e këtyre formave si fenomen.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të paraqitjes të të gjitha të dhënave të detajuara në tabelën e rrezikshmërisë, mund të përfundohet se ka progres në të gjitha fushat e menaxhimit në zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2023, Andaj kërkohet që drejtoritë përkatëse t'i marrin veprimet dhe aktivitetet e nevojshme për përmbushjen e plotë të Planit të Integritetit.

Për të arritur përfeksionin e plotë të Planit të Integritetit, Komuna e Istogut, respektivisht nga menaxhmenti i saj duhet edhe më shumë përkushtim në secilin Drejtori dhe sektor përkatës. Kryetari i Komunës duhet të kërkojë nga secila drejtori që t'i gjejnë format e duhura për ngritjen e zbatueshmërisë së plotë të këtij plani.

1. Të gjitha drejtoritë, sektorët (përgjegjës) duhet të raportojnë në baza periodike dhe varësisht nga nevoja e paraqitjes së problemeve, sfidave dhe avancimet që në një mënyrë ose tjetrën ndikojnë në zbatueshmërinë e planit.

2. Të rritet numri i trajnimeve me zyrtarët komunal me temën e integritetit dhe të korrupsionit në Komunë, në mënyrë që secili zyrtarët të jenë të informohet me qëllimin, masat dhe finalizimin e Planit të Integritetit.

3. Drejtoritë që kanë ngecur në zbatueshmërinë e Planit të Integritetit duhet të marrin masat konkrete për përmirësimin dhe arritjen e objektivave të integritetit dhe performancës së tyre.